

VENDIM
Nr.442, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.108, DATË 11.2.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT DHE PAGAT
E PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË
PASTRIMIT TË PARAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 7, të vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

EMERTIMI	KATEGORITE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIO NIT
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHK)	Shtesa per Kualifikim (SHP)	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Drejtor i Pergjithshem	II-a	10.050	2%	0	100.500
Zv/drejtor i Pergjithshem	II-b	10.050	2%	0	84.000
Drejtor	III-a/1	10.050	2%	0	55.000
Pergjegjes sektori	III-b	10.050	2%	0	49.000
Specialist	IV-a	10.050	2%	0	37.450
	IV-b	10.050	2%	0	25.850